

VENDIM
Nr.70, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT,
BAHÇALLËK, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i ujësjellësit, Bahçallëk, Shkodër.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe të komunës Bërdicë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 16 399 m² tokë/arë, e vlerësuar me 830 lekë/m², për shumën e përgjithshme 13 611 170 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 13 611 170 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësime.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.
 7. Bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë të bëjnë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONAREVE QE DO TE SHPRONESOHEN SI REZULTAT I NDERTIMIT TE
UJESJELLESIT BAHCALLEK SHKODER**

Nr.	EMRI	Zona Kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja Tote are	Cmimi /m2	Vlera ne lekë
1.	Kel Nusha Matija	1158	101/20	231	830	191 730
2	Ndreke Nush Matija	1158	101/22	231	830	191 730
3	Lek Pjetër Gjergji	1158	101/16	1851	830	1536330
4	Faik Riza Kasemi	1158	101/8	1388	830	1152040
5	Zef Tish Matja	1158	101/19	925	830	767750
6	Lore Paloke Gjergji	1158	101/18	1851	830	1536330
7	Martin Pashuk Gjergji	1158	101/17	1850	830	1535500
8	Xhemal Kasem Kasemi	1158	101/7	1388	830	1152040
9	Hysen Arif Koburja	1158	101/10	375	830	311250
10	Hysen Arif Koburja	1158	101/4	775	830	643250
11	Jonuz Arif Koburja	1158	101/5	775	830	643250
12	Jonuz Arif Koburja	1158	101/11	375	830	311250
13	Brahim Arif Koburja	1158	101/3	700	830	581000
14	Brahim Arif Koburja	1158	101/9	375	830	311250
15	Rexhep Taruk Velija	1158	101/15	566	830	469780
16	Dul Taruk Velija	1158	101/13	566	830	469780
17	Begir Taruk Velija	1158	101/14	566	830	469780
18	Adem Arif Koburja	1158	101/12	375	830	311250
19	Adem Arif Koburja	1158	101/6	775	830	643250
20	Tonin Nush Matija	1158	101/23	231	830	191730
21	Paulin Nush Matija	1158	101/21	230	830	190900
	Shuma			16 399		13 611 170

Totali 13 611 170 lekë

Vlera totale e këtij shpronësimi është 13 611 170 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë lekë).